



**QKSS**


Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

## Edicion special:

Pikëpamjet e qytetarëve ndaj ekstremizmit të dhunshëm  
dhe radikalizmit në Kosovë





**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË

## Edicion special:

Pikëpamjet e qytetarëve ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë

**Botues:** Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

**Projekti u mbështet nga:** National Endowment for Democracy

**Interpretues i të dhënave:** Vesë Kelmendi

**Redaktimi i brendshëm:** Florian Qehaja, Mentor Vrajolli, Skender Perteshi

**Redaktimi i jashtëm:** Shpend Kursani

Qershor 2016

Shënim: Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën shqipe.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen me Ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes ose të transmetohet në ndonjë formë apo me ndonjë mjet elektronik, mekanik ose ndryshe, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi për qëllime komerciale i të gjitha raporteve të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë nuk lejohet pa pëlqimin me shkrim të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë. Ju lutem kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420

Informatat e paraqitura në këtë raport janë përmbledhje e të dhënave të grumbulluara nga të anketuarit dhe duhet të trajtohen vetëm si të tilla. Raporti nuk është në asnjë mënyrë vlerësim definitiv i cilësisë së punës së institucioneve apo konkludim i rrezikshmërisë në vend. Ky raport u shërben studiuesve si dhe institucioneve si instrument për adresimin e mangësive të mundshme.

*Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptime të të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë apo të NED.*

---

# PËRMBAJTJA

---

ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË? .....	7
KUJT I DREJTOHET KY EDICION SPECIAL? .....	7
METODOLOGJIA .....	7
HYRJE.....	9
GJETJET KRYESORE: .....	10
1. PERCEPTIMET PUBLIKE PËR INSTITUCIONET FETARE .....	11
2. ANALIZIMI I BESUESHMËRISË NDAJ INSTITUCIONEVE FETARE E BAZUAR NË STRATIFIKIMET KRYESORE DEMOGRAFIKE TË QYTETARËVE TË KOSOVËS.....	14
2.1 Niveli i besueshmërisë në institucionet fetare .....	14
3. PERCEPTIMET PËR KËRCËNIMET DHE RREZIQET NGA EKSTREMIZMI I DHUNSHËM, LUFTËTARËT E HUAJ DHE KRIZA E REFUGJATËVE.....	19
3.1. Kërcënimet dhe rreziqet nga grupet ekstremiste (ISIS, AL-Nusra) dhe Krizës së valës së Refugjatëve nga Lindja e Mesme .....	20
3. 2 Perceptimet e qytetarëve për personat të cilët kthehen nga Siria dhe Iraku në Kosovë .....	23
3.3 Perceptimet e qytetarëve të Kosovës rreth punës së Qeverisë në luftimin e ekstremizmit.....	24
PUBLIKIMET E MËPARSHME NË KUADËR TË BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË...26	

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Besueshmëria e qytetarëve ndaj institucioneve fetare në Kosovë 2014/2015 .....	11
Figura 2: Besueshmëria në mes institucioneve fetare dhe shtetërore .....	12
Figura 3: Besueshmëria e qytetarëve në institucionet fetare sipas rajonit .....	13
Figura 4: Besueshmëria e qytetarëve të Kosovës në institucionet fetare sipas zonave rural/urban .....	15
Figura 5: Kontakti i qytetarëve të Kosovës me institucionet fetare sipas zonave rural/urban.....	15
Figura 6: Besueshmëria e qytetarëve në institucionet fetare sipas gjinisë .....	16
Figura 7: Besueshmëria e qytetarëve në institucionet fetare sipas fesë (Myslimanë, Katolik edhe Ortodoksë) .....	17
Figura 8: Kontakti i qytetarëve të Kosovës me institucionet fetare sipas fesë (Mysliman, Katolik, Ortodoks) .....	17
Figura 9: Besueshmëria e qytetarëve të Kosovës në institucionet fetare të ndara sipas rajoneve .....	18
Figura 10: Kontakti i qytetarëve të Kosovës me institucionet fetare të ndara sipas rajoneve .....	18
Figura 11: Perceptimet e qytetarëve rreth ekstremizmave të ndryshëm në Kosovë .....	20
Figura 12: Perceptimet e qytetarëve rreth kërcënimeve dhe rreziqeve nga grupet ekstremiste (ISIS dhe Al-Nusra) .....	21
Figura 13: Perceptimet e qytetarëve rreth kërcënimeve dhe rreziqeve nga refugjatët e Lindjes së Mesme.....	22
Figura 14: Perceptimet e qytetarëve rreth vendimit për pjesëmarrje në konfliktin Siri dhe Irak të individëve nga Kosova .....	22
Figura 15: Perceptimet e qytetarëve rreth rrezikut nga personat e kthyer nga konflikti Siri-Irak.....	23
Figura 16: Perceptimet e qytetarëve rreth të kthyerve nga Siria dhe Iraku .....	24
Figura 17: Përceptimet e qytetarëve rreth punës së Qeverisë së Kosovës rreth luftimit të ekstremizmit.....	25

---

## ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

---

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është program i veçantë i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), i hartuar për të shërbyer si publikim vjetor. Përveç gjetjeve të përgjithshme, programi nxjerrë edicione speciale në fusha të përcaktuara paraprakisht. Fokusi kryesor i BKS-së është matja e perceptimeve të opinionit publik për institucionet dhe politikëbërjen në fushën e sigurisë. Gjithashtu, ai matë perceptimin publik për kërcënimet e brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Kosovë. BKS-ja është një nga nismat më të mëdha, madje ndër të parat, që janë hartuar, zbatuar dhe komunikuar nga një institut vendor kërkimor. BKS-ja është unike në qasjen e saj metodologjike, siç është përshtatja e metodave kuantitative dhe kualitative me qëllim të ofrimit të rezultateve reale për perceptimin publik sa i përket çështjeve të lidhura me sigurinë.

---

## KUJT I DREJTOHET KY EDICION SPECIAL?

---

Ky edicion special i BKS-së i drejtohet një game të gjerë të akterëve që janë të interesuar t'i përcjellin perceptimet e qytetarëve për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin në Kosovë. Më saktësisht, ai i drejtohet një audience që është e interesuar t'i ndjekë trendet e opinionit publik në Kosovë, me theks të veçantë në besueshmërinë dhe kontaktin e qytetarëve të Kosovës në raport me institucionet fetare në Kosovë, kërcënimet dhe rreziqet që burojnë nga formacionet terroriste siç janë: ISIS dhe AL-Nusra; perceptimin për rehabilitimin e të kthyerve nga Siria dhe Iraku si dhe perceptimet për strategjinë e Qeverisë së Kosovës që merret me këtë dukuri. Në përgjithësi, BKS-ja u drejtohet politikbërësve në nivel shtetëror, aktorëve ndërkombëtarë në Kosovë, si edhe organizatave vendore, komuniteteve fetare, shoqërisë civile, komunitetit akademik dhe mediaeve.

---

## METODOLOGJIA

---

Edicioni special i BKS-së pasqyron perceptimet e qytetarëve rreth besueshmërisë në institucionet fetare, kërcënimet dhe rreziqet që burojnë nga grupet ekstremiste dhe kriza e refugjatëve nga Lindja e Mesme. Raporti ka pasur një qasje gjithpërfshirëse duke matur perceptimin jo vetëm nga perspektiva e ekstremitetit të dhunshëm në baza fetare por edhe të veprimeve dhe potencialeve të tjera ekstremiste në Kosovë. Po ashtu, është bërë krahasimi i besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore dhe atyre fetare, për të pasqyruar gjendjen dhe kredibilitetin rreth këtyre institucioneve.

Kjo u ka bërë të mundur interpretuesve të të dhënave të bëjnë një analizë në mënyrë të hollësishme nga prizmi i perceptimit publik, duke plotësuar vlerësimet profesionale, të cilat vijnë nga qarqet e politik-bërjes apo komuniteti akademik. Interpretimi pasqyron një grup faktorësh politik dhe shoqërorë që kanë ndikuar në mendimin e të anketuarve. Analiza e opinionit të qytetarëve bazohet edhe në përfshirjen e drejtpërdrejtë të interpretuesit të të dhënave në intervistat e drejtpërdrejta me të anketuarit. Për më tepër, përpjekjet e ekipit të QKSS-së për shkoqitjen dhe analizën e mëtejme të mendimeve të përfshira në këtë edicion special janë mbështetur nga grupet e fokusit dhe hulumtuesit e terrenit.

Përgjigjet në pyetësin e BKS-së janë mbledhur përmes intervistave të drejtpërdrejta që u realizuan në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Shumica e pyetjeve ishin të llojit të mbyllur, në formë të shkallës pesë-pikëshe të Liker-tit. Por kishte edhe pyetje të hapura për t'u dhënë të anketuarve mundësinë që të jepnin mendimin e tyre pa qenë nevoja të zgjedhin opsione të përcaktuara paraprakisht. Mostrimi, pilotimi dhe intervistimi u realizua nga ekipi i QKSS-së në përbërje të 35 hulumtuesve në terren. Mostra kombëtare mbi bazën e së cilës u hartua hulumtimi ka përmbajtur 1,070 amvisëri, duke ndjekur një mostër përfaqësuese të popullatës mbi moshën 18 vjeçare në Kosovë. Përbërja etnike e të anketuarve ishte si vijon: 88.4 përqind shqiptarë të Kosovës, 7.7 përqind serbë të Kosovës dhe 3.9 përqind të tjerë (prej të cilëve 1.4 përqind turq, 0.6 përqind boshnjakë, 1.0 përqind nga komuniteti Romë, Ashkali e Egjiptasë (RAE) dhe të tjerët përfshijnë goranë, kroatë dhe malazezë).

Korniza e mostrës është bazuar në kodet telefonike të rajoneve dhe si e tillë ka përfshirë 7 rajone: Ferizajin, Gjakovën, Gjilanin, Mitrovicën, Pejën, Prishtinën dhe Prizrenin. Faza e parë e grupimit gjeografik ishte e bazuar në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë së Kosovës të vitit 2012, ndërsa faza e dytë ka përfshirë grupimin e mostrave sipas zonave komunale me mostër të stratifikuar fshat/qytet, sipas numrit të ekonomive shtëpiake. Kurse në fazën e fundit u zbatua metoda e mostrës së rastit, duke shfrytëzuar "metodën e ditëlindjes" më të afërt. Mostrimi sipas rastit garanton që secili banor në Kosovë të ketë mundësi të barabartë për t'u përzgjedhur për intervistim. Me mostrën e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendët në qëndrimet dhe perceptimet e gjithë popullsisë së moshës madhore të Kosovës në përgjithësi. Margjina e gabimit është 3 përqind, me një interval besueshmërie prej 95 përqind.

Para fillimit të punës në terren, në fillim të tetorit të vitit 2015, u realizua një pilot intervistë me qëllim të testimit të realizueshmërisë së pyetësin. Ekipi hulumtues më pas raportoi se pilot intervista kishte qenë e suksesshme dhe se nuk ishte hasur ndonjë problem me pyetjet që u ishin bërë të anketuarve. Të gjitha intervistat u realizuan nga 21 deri më 29 tetor 2015. Përpunimi dhe analiza e të dhënave janë bërë duke përdorur softuerin SPSS.



## HYRJE

Ekstremizmi i dhunshëm është term i ri që ka filluar të përdoret globalisht, i cili në interpretimin e saj të ngushtë i referohet fenomenit të personave që janë bashkangjitur apo që përbëjnë potencial për bashkangjitje formacioneve ekstremiste apo terroriste, siç janë së voni organizatat *ISIS* dhe *Al-Nusra*. Deri më tani disa shtete që janë renditur përkrah luftës kundër *ISIS* dhe grupeve tjera terroriste janë ballafaquar me pasojat e sulmeve direkte nga këto grupe. Si një ndër shtetet aleate të “Koalicionit Global kundër luftës së Terrorizmit”<sup>1</sup>, anëtare e së cilës u bë zyrtarisht në vitin 2015, Kosova nuk ka patur ndonjë kërcënim direkt. Megjithatë, Kosova është cilësuar si vend me një potencial të lartë të rekrutimit dhe përhapje të ideologjisë radikale. Këtë e vërtetojnë edhe profilet e pjesëmarrësve nga Kosova në luftën e Sirisë dhe Irakut të cilat ngërthejnë elemente dhe motive të ndryshme.

Ndër faktorët kyç për këtë kryesisht konsiderohen të jenë faktorët socio-politik e ekonomik, mes tjerash: sistemi i degraduar i arsimit, papunësia mes të rinjve (60 % në Kosovë)<sup>2</sup>, izolimi shoqërorë dhe individual, ekzistimi i vetë ideologjisë ekstremiste në qarqe të ndryshme si dhe socializimi dhe grupimi i të rinjve rreth këtyre qarqeve. Mirëpo rol të rëndësishëm ka luajtur edhe mos efikasiteti i institucioneve shtetërore dhe i atyre fetare për të parandaluar përhapjen e ideologjisë ekstremiste në shtetin e Kosovës, problem ky që poashtu e kanë vendet e tjera të rajonit dhe ato të Evropës. Një ndër faktorët që nuk mund të lihet anash pa përmendur, e që ka ndikuar në joshjen e të rinjve, është fakti i izolimit të tyre në zonat rurale, cytja me ligjërime nga disa imamë të cilët tashmë janë në mesin e të arrestuarve për rekrutim dhe bashkëpunim me grupet ekstremiste.

Ky edicion special i barometrit të sigurisë së QKSS-së, do të shpalosë nivelin e besueshmërisë së qytetarëve dhe kontaktit të tyre me institucionet fetare dhe perceptimet e tyre rreth kërcënimeve nga grupet ekstremiste si dhe rreziku nga personat të cilët janë kthyer nga konflikti i Lindjes së Mesme në Kosovë.

1 Country Reports on Terrorism: <http://www.state.gov/documents/organization/239631.pdf>

2 Agjencia e statistikave të Kosovës/Rezultatet e anketës së fuqisë punëtore 2014: <https://ask.rks-gov.net/images/files/Anketa%20e%20Grupimeve%20te%20Treguesve%20te%20Shumefishte%20ne%20Republiken%20e%20Kosoves%202013-2014.pdf>

---

## GJETJET KRYESORE:

---


- Trendët e përgjithshme tregojnë se të anketuarit ndajnë perceptime më pozitive ndaj institucioneve fetare krahasuar me ato shtetërore. Qytetarët që deklaruan se i besojnë punës së Qeverisë janë 14 përqind, punës së gjykatave rreth 22 përqind krahasuar me institucionet fetare ku besueshmëria ndaj tyre është 57 përqind.
- Tradicionalisht qytetarët e Kosovës kanë pasur respekt ndaj institucioneve fetare në Kosovë, por jo domosdoshmërisht pikëpamjet e tyre reflektojnë në punën të cilën kryejnë këto institucione. Një ekzaminim i afërt i rezultateve tregon se ka dallime mes zonave rurale dhe urbane sa i përket besimit në institucione fetare. P.sh. rreth 65 përqind e qytetarëve të intervistuar të cilët jetojnë në zonat rurale besojnë më shumë ndaj institucioneve fetare krahasuar me 49 përqind e atyre që jetojnë në zonat urbane. Megjithatë, kontakti me institucionet fetare është në nivel të ulët.
- Rreth 76 përqind e qytetarëve i shohin si shumë rrezik organizatat terroriste të tipit *ISIS* dhe *Al-Nusra*, kurse pjesa tjetër, apo 8 përqind i shohin si rrezik mesatar këto organizata.
- Rreth 55 përqind deklaruan se qytetarët e Kosovës të kthyer nga lufta e Sirisë dhe Irakut duhet t'i nënshtrohen programeve strikte të ri-integrimit, rehabilitimit, dhe deradikalizmit. Pjesa tjetër, apo 22 përqind, e qytetarëve të anketuar mendojnë se ata duhet të arrestohen qysh në momentin e kthimit të tyre në Kosovë, ndërsa 15 përqind mendojnë se ata duhet t'u ndalohej kthimi në Kosovë.
- Së fundi, rreth 57 përqind e qytetarëve të anketuar deklaruan se Qeveria e Kosovës dështoi në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë, ndërsa në anën tjetër rreth 35 përqind e të anketuarve e shohin si deri diku të suksesshme punën e Qeverisë në drejtim të luftimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë.

## 1. PERCEPTIMET PUBLIKE PËR INSTITUCIONET FETARE


Në suaza të matjes së perceptimit të besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve fetare, ky edicion i Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS), përfshinë edhe nivelin e besueshmërisë ndaj këtyre institucioneve karshi atyre shtetërore përfshirë qeverinë dhe gjykatat.

Gjetjet tregojnë se nga viti 2014 në vitin 2015 ka pasur rritje të lehtë të besimit të qytetarëve ndaj institucioneve fetare. Nga 55 përqind sa kanë shprehur besim në vitin 2014, numri është rritur në 57 përqind në vitin 2015. Megjithatë, qytetarët janë deklaruar edhe rreth neglizhencës nga institucionet shtetërore, dhe kjo ka ndikuar me shumë gjasë që kryesisht të rinjtë të zhvillojnë kontakte më shumë me prijësit fetarë, gjë që ka ndikuar direkt edhe në vlerësimin për besueshmërinë ndaj institucioneve fetare në Kosovë.

**Figura 1: Besueshmëria e qytetarëve ndaj institucioneve fetare në Kosovë 2014/2015**



Tregues më i mirë i kësaj janë gjetjet që flasin për 61 përqind të qytetarëve që nuk janë të kënaqur me punën e Qeverisë. Vetëm 14 përqind janë deklaruar se i besojnë Qeverisë dhe janë të kënaqur me punën e saj. Vetëm 22 përqind e qytetarëve i besojnë punës së gjykatave në Kosovë ndërsa rreth 51 përqind e tyre nuk ju besojnë fare gjykatave. Besueshmërinë e ulët në Qeverinë e Kosovës dhe gjykatat respoendentët e arsyetojnë me korrupsionin e lartë në institucionet e vendit, numrin e lartë të papunësisë, sidomos tek të rinjtë, pakënaqësitë në sferën e sundimit të ligjit, edukimit dhe zhvillimit të ulët ekonomik.

**Figura 2: Besueshmëria në mes institucioneve fetare dhe shtetërore**

Më poshtë mund të shihni nivelin i besueshmërisë ndaj institucioneve fetare në nivel rajonal si në: *Shqipëri, Maqedoni, Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi*. Sipas gjetjeve del se edhe në Shqipëri dhe Bosnjë Hercegovinë ka pasur rritje të besueshmërisë ndaj institucioneve fetare. Përderisa 44 përqind e qytetarëve të Shqipërisë i besuan institucioneve fetare gjatë vitit 2014,<sup>3</sup> në vitin 2015<sup>4</sup> shifra ka arritur në 52 përqind. Ndërkaq në Bosnje dhe Hercegovinë nga 51 përqind në vitin 2014<sup>5</sup>, shifra ka arritur në 65 në vitin 2015.<sup>6</sup>


Në Maqedoni niveli i besueshmërisë ndaj institucioneve fetare në vitin 2014 ka qenë 68 përqind. Të dhëna për vitin 2015 nuk janë akoma në dispozicion. Në Serbi qytetarët kanë shfaqur besim mesatar ndaj kishës ortodokse. Gjatë hulumtimeve të vitit 2014 qytetarët serb deklaruan se besojnë rreth 32 përqind në punën e kishës ortodokse në Serbi.

3 Raport nga Pasos Poll 2014: <http://pasos.org/pasos-poll-citizens-of-six-balkan-countries-identify-political-parties-as-the-most-untrustworthy-institution-in-their-respective-countries/>

4 Raporti I IDM-së 2015: [http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/Opinion-Poll\\_trust-in-government\\_2015.pdf](http://idmalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/Opinion-Poll_trust-in-government_2015.pdf)

5 Raport nga Analitika/ Center for Social Research, 2014 (BIH): [http://pasos.org/wp-content/uploads/2014/11/povjerenje\\_fact\\_sheet\\_english.pdf](http://pasos.org/wp-content/uploads/2014/11/povjerenje_fact_sheet_english.pdf)

6 Raport nga Analitika / Center for Social Research, 2015 (BIH): [file:///C:/Users/User/Downloads/povjerenja\\_gradana\\_u\\_vlast\\_eng%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/povjerenja_gradana_u_vlast_eng%20(1).pdf)

**Figura 3: Besueshmëria e qytetarëve në institucionet fetare sipas rajonit**

Ka disa indikacione që kanë ndikuar në rritjen e besimit ndaj institucioneve fetare në vendet e Ballkanit. Në rastin e Shqipërisë, qytetarët të cilët kanë filluar ta praktikojnë fenë janë kryesisht të rinjtë pas rënies së komunizmit, kjo për faktin se në periudhën transitore politike në Shqipëri qytetarët filluan të gjejnë përkrahje në institucionet fetare për shkak të neglizhencës nga ana e institucioneve shtetërore. Në rastin e Maqedonisë janë kryesisht çështjet politike ato të cilat kanë ndikuar që qytetarët të kenë besim më të madh ndaj institucioneve fetare. Përçarja politike, bëri që edhe komuniteti i maqedonasve si dhe ai i shqiptareve të krijojnë kontakte më shumë me institucionet fetare sesa ato shtetërore. Kur jemi tek Bosnja, flasim për një indikacion pak më ndryshe sa i përket rritjes së besueshmërisë ndaj institucioneve fetare. Fillimisht, ishte lufta në Bosnjë ajo që shkaktoi një krize identiteti tek komuniteti i boshnjakëve, si dhe një ndarje etnike me formimin e Republikës Serbe brenda territorit të Bosnjës. Më pas kanë filluar edhe ndikimet e kishës ortodokse. Po ashtu, lufta që kishte ndodhur në BeH ka pasur edhe elemente të një lufte fetare karshi luftës kryesisht nacionaliste. Si pasojë, Bosnja sot shihet si një ndër vendet me besueshmërinë më të lartë ndaj institucioneve fetare krahasuar me vendet e tjera të rajonit. Megjithatë, ndër shkaqet që mund të themi se evidentohen tek të gjitha vendet e Ballkanit përëndimor kur flitet për ngritjen e besueshmërisë tek institucionet fetare janë: niveli i lartë i korrupsionit në institucione shtetërore (pavarësisht se ai ekziston edhe në ato fetare), shkalla e lartë e papunësisë, sistemet e dobëta të arsimit si dhe mungesa e sundimit të ligjit.

---

## 2. ANALIZIMI I BESUESHMËRISË NDAJ INSTITUCIONEVE FETARE E BAZUAR NË STRATIFIKIMET KRYESORE DEMOGRAFIKE TË QYTETARËVE TË KOSOVËS


---

Në këtë pjesë të raportit trajtohet besueshmëria dhe kontaktet e qytetarëve të Kosovës me institucionet fetare në mënyrë më të detajuar dhe të ndara sipas zonave urbane dhe rurale, sipas gjinisë dhe sipas rajoneve. Gjetjet në terren tregojnë se qytetarët e Kosovës, pa dallim feje përballen me probleme kryesisht të ngjashme, sa i përket besueshmërisë dhe kontaktit të tyre me institucionet fetare. Andaj, në këtë pjesë, do t'i kushtohet rëndësi e veçantë besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve fetare, si dhe neglizhencës së këtyre institucioneve në raport me qytetarët. Në vazhdim janë krahasuar zonat rurale dhe urbane, ku shihet qartë që kryesisht qytetarët, të cilët vijnë nga zonat rurale iu besojnë më shumë institucioneve fetare, krahasuar me qytetarët të cilët jetojnë në zonat urbane. Kjo ndodh për arsye se shumica e qytetarëve në zonat rurale janë të izoluar, nuk vizitohen as nga ndonjë zyrtar nga institucionet shtetërore dhe kjo ndikoi që ata nevojat dhe pakënaqësitë e tyre t'i shprehin në institucione fetare apo tek prijësit fetar.

### 2.1 Niveli i besueshmërisë në institucionet fetare


Të dhënat e BKS-së tregojnë se gjatë vitit 2015, njerëzit që jetojnë në zonat rurale kanë pasur më shumë besim në institucionet fetare në krahasim me ata që kanë jetuar në zonat urbane. Rreth 65 përqind e qytetarëve në zonat rurale *besojnë* në institucionet fetare krahasuar me 49 përqind të atyre që jetojnë në zonat urbane. Ndërsa rreth 19 përqind e qytetarëve të anketuar në zonat rurale deklaruan se besojnë *deri diku* në punën e institucioneve fetare, krahasuar me 22 përqind e atyre në zonat urbane. Rreth 16 përqind e atyre në zonat rurale deklaruan se *nuk i besojnë* punës së institucioneve fetare, krahasuar me 27 përqind e atyre në zonat urbane.

**Figura 4: Besueshmëria e qytetarëve të Kosovës në institucionet fetare sipas zonave rural/urban**



Rol të rëndësishëm në besueshmërinë e tyre ndaj institucioneve fetare e ka luajtur kontakti i tyre direkt me ndonjë zyrtar apo përfaqësues nga këto institucione. Rreth 43 përqind e qytetarëve në zonat rurale kanë kontaktuar me institucionet fetare në Kosovë, krahasuar me 38 përqind e atyre që jetojnë në zonat urbane. Kurse rreth 57 përqind e të anketuarve në zonat rurale deklaruan se nuk kanë kontakte me institucionet fetare në Kosovë, krahasuar me 62 përqind e të anketuarve në zonat urbane që nuk kishin asnjë kontakt me institucionet fetare. Tradicionalisht qytetarët e Kosovës i respektojnë institucionet fetare. Mirëpo, jo domosdoshmërisht pikëpamjet e tyre reflektojnë rreth punës të cilën e kryejnë këto institucione në Kosovë. Me shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm janë fuqizuar më shumë zërat të cilët kanë kritikuar institucionet fetare gjatë punës së tyre, gjë të cilën në periudhat e më hershme qytetarët nuk kanë pasur guxim që ta bëjnë apo të sfidojnë autoritetin e institucionit fetar.


**Figura 5: Kontakti i qytetarëve të Kosovës me institucionet fetare sipas zonave rural/urban**



Interesant është fakti që shumica e grave në Kosovë në njërin anë janë krejtësisht të përjashtuara nga institucionet fetare dhe neglizhohen brenda strukturave udhëheqëse

të këtyre institucioneve, e në anën tjetër ato të kenë më shumë besim se sa burrat në punën e institucioneve fetare në Kosovë. Rreth 62 përqind e tyre deklaruan se besojnë në këto institucione krahasuar me burrat, ku rreth 51 përqind e tyre deklaruan se besojnë gjithashtu në punën e institucioneve fetare. Sa i përket mosbesimit të tyre rreth 21 përqind e grave të anketuara deklaruan se nuk besojnë në punën e institucioneve fetare, krahasuar me 23 përqind e burrave të anketuar.

**Figura 6: Besueshmëria e qytetarëve në institucionet fetare sipas gjinisë**




Ndërsa kur u pyetën rreth kontaktit të tyre me institucionet përkatëse rreth 48 përqind e burrave deklaruan se kanë kontaktuar me institucionet fetare, krahasuar me 33 përqind nga gratë të cilat pohuan se kanë pasur ndonjë kontakt me institucionet fetare. Ndërsa rreth 52 përqind e burrave mohuan se kanë kontaktuar me institucionet fetare në Kosovë, krahasuar me 67 përqind e grave. Sipas vëzhgimeve në terren, qytetarët shprehën pakënaqësi për kushtet të cilat nuk i plotësojnë xhamitë e Kosovës, sidomos gratë nga zonat rurale nuk shihen brenda këtyre institucioneve madje edhe brenda ligjëtimeve që mbahen, si dhe nuk ka pjesëmarrëse të grave në proceset e vendimmarrjes. Një pjesë tjetër e qytetarëve ndërkaq kanë deklaruar se edhe institucionet fetare kanë parregullsi dhe korrupsion përbrenda strukturave udhëheqëse.

Kur flasim për trendet sipas fesë të ndara në *Mysliman*, *Katolik* dhe *Ortodoks*, gjetjet tregojnë se 59 përqind e komunitetit mysliman në Kosovë beson në punën e institucioneve fetare, krahasuar me 57 përqind e komunitetit katolik dhe 46 përqind e komunitetit ortodoks. Nga ana tjetër, perceptimet e komuniteteve rreth mosbesimit ndaj institucioneve fetare janë përafërsisht të ngjashme. Rreth 21 përqind nga komuniteti mysliman nuk beson fare në punën që kryejnë institucionet fetare, rreth 20 përqind nga komuniteti katolik dhe rreth 22 përqind nga komuniteti ortodoks nuk kanë fare besim në punën e institucioneve të tyre fetare.




**Figura 7: Besueshmëria e qytetarëve në institucionet fetare sipas fesë (Myslimanë, Katolik edhe Ortodoksë)**




Në figurën 8 më poshtë mund të shihet që qytetarët e intervistuar përkundër besimit ndaj institucioneve fetare, nuk kanë kontakte me ato, apo ndonjë zyrtar përfaqësues të tyre. Sa i përket kontaktit me institucionet fetare, 63 përqind e komunitetit mysliman mohuan të kenë kontaktuar me ato. Nga komuniteti katolik të njëjtën e kanë mohuar 46 përqind ndërsa 28 përqind nga komuniteti ortodoks. Kjo tregon edhe për lidhjen që këto komunitete e kanë me institucionet e tyre fetare përkatëse, ku shihet se komuniteti ortodoks është në kontakt shumë më të madh me institucionet e tyre fetare se sa komuniteti katolik e ai mysliman.

**Figura 8: Kontakti i qytetarëve të Kosovës me institucionet fetare sipas fesë (Mysliman, Katolik, Ortodoks)**




Kurse sa i përket *besimit* në institucione fetare sipas rajoneve dalin këto përqindje: *Ferizaj* (62 përqind), *Prizren* (59 përqind), *Gjakovë* (55 përqind), *Pejë* (59 përqind), *Gjilan* (59 përqind), *Mitrovicë* (64 përqind) dhe *Prishtinë* (52 përqind). Ndërsa të anketuarit të cilët *nuk i besojnë* punës së institucioneve fetare deklaruan në këtë mënyrë: *Ferizaj* (15 përqind), *Prizren* (20 përqind), *Gjakovë* (22 përqind), *Pejë* (27 përqind), *Gjilan* (16 përqind), *Mitrovicë* (8 përqind) dhe *Prishtinë* (30 përqind).

**Figura 9: Besueshmëria e qytetarëve të Kosovës në institucionet fetare të ndara sipas rajoneve**



Sa i përket kontaktit të qytetarëve me institucionet fetare sipas rajoneve përqindjet janë këto: *Prishtinë* (33 përqind), *Mitrovicë* (42 përqind), *Gjilan* (51 përqind), *Pejë* (38 përqind), *Gjakovë* (35 përqind), *Prizren* (39 përqind) dhe *Ferizaj* (38 përqind). Ndërsa një përqindje mjaft e madhe nga të anketuarit nuk kishin kontaktuar me institucionet fetare. Qytetarët të ndarë sipas rajoneve nuk kishin asnjë kontakt me institucionet fetare si në vijim: *Prishtinë* (67 përqind), *Mitrovicë* (58 përqind), *Gjilan* (49 përqind), *Pejë* (61 përqind), *Gjakovë* (65 përqind), *Prizren* (61 përqind) dhe *Ferizaj* (62 përqind).

**Figura 10: Kontakti i qytetarëve të Kosovës me institucionet fetare të ndara sipas rajoneve**




---

### 3. PERCEPTIMET PËR KËRCËNIMET DHE RREZIQET NGA EKSTREMIZMI I DHUNSHËM, LUFTËTARËT E HUAJ DHE KRIZA E REFUGJATËVE

---

Raporti i vitit të kaluar i publikuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), rreth “Shkaqeve dhe pasojave të përfshirjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtar të huaj në Siri dhe Irak” ndikoi që institucionet e sigurisë, ato qeveritare, shoqëria civile dhe komuniteti fetar në Kosovë ta trajtojnë më me seriozitet këtë fenomen. Analizat kanë treguar se problemi i ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm kërkon një qasje të veçantë dhe specifike sa i përket mënyrës së kuptimit dhe të trajtimit të mëtutjeshëm të këtij fenomeni, respektivisht të personave të cilit ishin pjesë e këtij konflikti.

Të anketuarit poashtu janë pyetur në lidhje me format e ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Tri kanë qenë opsionet për të cilat anketuesit kanë patur mundësinë të zgjedhin: (1) dhuna në baza nacionale/etnike, (2) dhuna në baza fetare; (3) trazirat të nxitura nga militantizmi partiak/politik (eskalimi i raporteve pozite/opozitë). Rreth 36 përqind e qytetarëve të anketuar deklaruan se dhuna në baza nacionale/etnike paraqet rrezik ndërsa në anën tjetër rreth 42 përqind e qytetarëve të anketuar e vlerësuan këtë fenomen si deri diku të rrezikshëm, kurse 21 përqind e qytetarëve të anketuar e vlerësuan si aspak të rrezikshëm dhunën në baza nacionale etnike. Rreth 60 përqind e qytetarëve të anketuar e vlerësuan militantizmin partiak/politik (eskalimi i raporteve pozitë/opozitë) si rrezik, ndërsa rreth 30 përqind e qytetarëve të anketuar e vlerësuan si deri diku të rrezikshëm këtë fenomen, kurse pjesa tjetër apo 8 përqind nuk e vlerësuan fare rrezik. Qytetarët e shohin dhunën fetare më pak si rrezik në krahasim me dy të lartëpërmendurat P.sh. rreth 29 përqind e qytetarëve të anketuar e vlerësuan si rrezik dhunën në baza fetare, kurse 34 përqind e tyre e vlerësuan si rrezik mesatar këtë fenomen. Pjesa tjetër apo 36 përqind e tyre dhunën në baza fetare e vlerësuan si aspak të rrezikshme. Zhvillimet e fundit në Kuvendin e Kosovës, ndërmjet pozitës dhe opozitës, protestat e dhunshme, si dhe kriza politike në vend, kanë ndikuar që qytetarët e vendit kanë vlerësuar ekstremizmin politik si si rrezikun më të lartë për vendin Në krahasim me dy rreziqet tjera për të cilat kanë pasur mundësi t’i emërojnë si të tilla.

**Figura 11: Perceptimet e qytetarëve rreth ekstremizmave të ndryshëm në Kosovë**


### 3.1. Kërcënimet dhe rreziqet nga grupet ekstremiste (ISIS, AL-Nusra) dhe Krizës së valës së Refugjatëve nga Lindja e Mesme

Qytetarët janë pyetur edhe për atë se sa ndihen të kërcënuar direkt nga organizatat ekstremiste si ISIS dhe Al-Nusra. Rreth 76 përqind e qytetarëve shohin *shumë rrezik* nga këto organizata, kurse pjesa tjetër, apo 8 përqind shohin *rrezik mesatar* nga këto organizata. Rreth 13 përqind ndërsa nuk shohin *rrezik* nga to. Këto vlerësime vijnë si shkak i konfliktit në Siri dhe Irak, përfshirjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtar të huaj përkrah këtyre organizatave, si dhe diskursit alarmant mediatik. Këto të dhëna nuk kanë dallime të mëdha nga botimi i raportit të vitit të kaluar rreth shkaqeve dhe pasojave të përfshirjes së qytetarëve në këto konflikte të huaja, ku janë të paraqitura procesi i rekrutimit, ndikimi që mund të hasin shumë të rinj, joshja dhe metodat e përdorura nga grupet ekstremiste.<sup>7</sup> Qytetarët kanë shprehur shqetësimet e tyre rreth kërcënimeve dhe rreziqeve që paraqesin këto organizata, dhe vlerësuan se këto grupe Kosovën e shohin më shumë si vend “potencial” të rekrutimit të të rinjve se sa për ndonjë sulm të mundshëm terrorist. Qëllimi i grupeve ekstremiste më konkretisht *ISIS-it*, është që t’i sulmojë shtetet, të cilat kanë ndikim në marrëdhëniet ndërkombëtare ku qëllimi final i tyre është mbjellja e frikës dhe pasigurisë të popujt e Evropës dhe më gjerë. Në anën tjetër, rrezikshmëria që i kanoset Kosovës është për faktin se kemi individë të cilët veprojnë ende brenda grupeve ekstremiste apo janë të radikalizuar, dhe mund të kenë mundësi rekrutimi të qytetarëve të tjerë të Kosovës. Rrezikshmëria që mund t’i kanoset rajonit të Ballkanit nga grupet ekstremiste është ambienti i tyre

<sup>7</sup> Raport mbi shkaqet dhe pasojat nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë: <http://ëëë.qkss.org/sq/Botime-t%C3%AB-Ve%C3%A7anta/Raport-per-shkaqet-dhe-pasojat-e-perfshirjes-se-qytetareve-te-Kosoves-si-luftetare-te-huaj-ne-Siri-dhe-Irak-408>


në zona të ndryshme kryesisht të pa zhvilluara, që ta kenë më të lehtë rekrutimin e vazhdueshëm, në shtetet që janë përballur me një të kaluar jo të mirë, sikurse në rastin e Kosovës gjatë vitit 1999. Përhapja e ideologjisë së tyre fokusohet më shumë në vendet ku ka mungesë të edukimit të mirëfilltë, në vendet ku nuk ka stabilitet të duhur politik, sundim të ligjit, mungesës të zhvillimit ekonomik, të cilat janë shkaktarë i radikalizmave të ndryshëm - dhe jo vetëm i atyre fetarë. Ndërkaq këto grupe paraqesin anën dhe natyrën e tyre të radikalizmit ku edhe synojnë të rekrutojnë

**Figura 12: Perceptimet e qytetarëve rreth kërcënimeve dhe rreziqeve nga grupet ekstremiste (ISIS dhe Al-Nusra)**




Qytetarët janë pyetur gjithashtu edhe rreth asaj se a shohin rrezik nga refugjatët e Lindjes së Mesme. Rreth 45 përqind e qytetarëve të anketuar deklaruan se ardhja e refugjatëve nga Lindja e Mesme paraqet rrezik për sigurinë në vend, kurse 17 përqind e të anketuarve deklaruan mendime të rezervuara sa i përket ardhjes së refugjatëve në Kosovë. Kjo përqindje e lartë për nga perceptimet e qytetarëve rreth refugjatëve tregon që shoqëria jonë nuk është e gatshme të pranojë të huaj, gjë që është një trend me të cilin po ballafaqohet përgjithësi Evropa Lindore. Në anën tjetër qytetarët vlerësuan ndërlidhjen e shpeshtë në media mes ISIS-it dhe refugjatëve dhe kjo ka krijuar konfuzion tek qytetarët që ata të vlerësojnë pozitivisht ardhjen e tyre. Ndërsa 37 përqind e qytetarëve të anketuar mendojnë se ardhja e refugjatëve nga Lindja e Mesme nuk paraqet ndonjë rrezik për Kosovën dhe nuk ka ndonjë problem apo kërcënim për sigurinë në vend nga ardhja e tyre. Qytetarët të cilët vlerësuan pozitivisht ardhjen e tyre ishte për shkak të solidarizimit të tyre që dikur edhe qytetarët nga Kosova ishin refugjatë në vende të ndryshme të botës.

**Figura 13: Perceptimet e qytetarëve rreth kërcënimeve dhe rreziqeve nga refugjatët e Lindjes së Mesme**



Pasi që Kosova kishte rreth 300 qytetarë të përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut, që nga fillimi i luftimeve e deri në ditët e sotme, shumica e të anketuarve treguan një mendim negativ rreth përfshirjes së qytetarëve të Kosovës si luftëtar të huaj në luftën e Sirisë dhe Irakut. Rreth 95 përqind e qytetarëve të anketuar vlerësuan se përfshirja e qytetarëve të Kosovës si luftëtar të huaj në luftën e Sirisë dhe Irakut, ishte dhe vazhdon të jetë e dëmshme për Kosovën. Vetëm një përqindje e papërfillshme mendon ndryshe apo nuk ka mendim.


**Figura 14: Perceptimet e qytetarëve rreth vendimit për pjesëmarrje në konfliktin Siri dhe Irak të individëve nga Kosova**




### 3.2 Perceptimet e qytetarëve për personat të cilët kthehen nga Siria dhe Iraku në Kosovë

Një pjesë e madhe e qytetarëve të Kosovës të përfshirë në luftën e Sirisë dhe Irakut, si luftëtar të huaj, janë kthyer në Kosovë, për motive dhe arsye të ndryshme. Qytetarët e anketuar janë pyetur rreth rrezikut që ata mendojnë se të kthyerit nga lufta e Sirisë dhe Irakut paraqesin për vendin. Statistikisht, 75 përqind e të anketuarve deklaruan se kthimi i tyre në Kosovë është rrezik për sigurinë shtetërore, kurse 23 përqind e tyre deklaruan se kthimi nga vatrat e luftës në Siri dhe Irak nuk paraqet aspak rrezik për vendin tonë. Në anën tjetër, rreth 2 përqind nuk kishin fare mendim rreth rrezikut të tyre në shoqërinë tonë.

**Figura 15: Perceptimet e qytetarëve rreth rrezikut nga personat e kthyer nga konflikti Siri-Irak**



Kur u pyetën në lidhje me trajtimin e qytetarëve të rikthyer nga lufta e Sirisë dhe Irakut, 22 përqind e qytetarëve të anketuar mendojnë se të kthyerit nga lufta e Sirisë dhe Irakut duhet të *arrestohen* qysh në momentin e kthimit të tyre në Kosovë, ndërsa 15 përqind e qytetarëve të anketuar mendojnë se qytetarët e Kosovës të cilët janë të përfshirë në konfliktin e Sirisë dhe Irakut duhet tu *ndalohet kthimi në Kosovë*. Qytetarët kishin rezervat e tyre rreth disa të kthyerve nga konflikti i Sirisë dhe Irakut, rreth qëllimit të kthimit të tyre rrezikut të cilët paraqesin për vendin, si dhe mundësisë që ata mund të ndikojnë në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë, si dhe mundësisë së rekrutimit të rinjve të tjerë për tu bashkuar organizatave si *ISIS* dhe *Al-Nusra*. Duke pasur parasysh faktin që disa nga të kthyerit u intervistuan nga mediat ndërkombëtare dhe vendore, kjo zbuti mendimin e disa të anketuarve ku rreth 6 përqind e tyre deklaruan se personat (qytetarët) e kthyer nga Siria dhe Iraku nuk paraqesin *fare rrezik* ndërsa rreth 1.5 përqind e tyre hezituan të jepin mendim rreth trajtimit të tyre. Përkundër faktit që qytetarët kthimin e tyre e shohin si rrezik për vendin, një pjesë tjetër e qytetarëve kishin mendim mjaft pozitiv rreth trajtimit të tyre pasi që kthehen në Kosovë, si dhe masave të cilat duhet të ndërmerren nga institucionet shtetërore me luftëtarët e huaj. Rreth 55 përqind deklaruan se të kthyerit nga lufta e Sirisë dhe Irakut duhet t'i nënshtrohen programeve strikte të *ri-integritimit, rehabilitimit, dhe deradikalizimit*.

**Figura 16: Perceptimet e qytetarëve rreth të kthyerve nga Siria dhe Iraku**

### 3.3 Perceptimet e qytetarëve të Kosovës rreth punës së Qeverisë në luftimin e ekstremizmit

Kuvendi i Kosovës gjatë vitit 2015 miratoi *“Ligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit (Ligji Nr. 05/L-002)”*<sup>8</sup> me qëllim të mbrojtjes së interesit shtetëror, ku sipas këtij ligji përcaktohen dispozitat penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë apo policinë e huaj jashtë territorit të Kosovës. Dispozitat që parasheh ky ligj janë zbatimet e dënimeve ndaj çdo personi që merr pjesë apo organizon, rekruton apo ndihmon financiarisht personat që të marrin pjesë në konfliktet jashtë territorit të Kosovës. Pas këtij ligji Qeveria e Kosovës hartoi edhe dokumentin: *“Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2013-2020”*<sup>9</sup>, duke i kushtuar rëndësi të veçantë personave të cilët janë kthyer nga Siria dhe Iraku si dhe trajtimi i tyre që duhet bërë nga institucionet e vendit. Rol të rëndësishëm në luftimin e ekstremizmit pati edhe Policia e Kosovës ku filloi me arrestimet e tyre dh të tjerëve dhe bastisjet në lokacione të ndryshme të vendit duke identifikuar mes tyre edhe imamët të cilët ishin rekrutues potencial dhe disa persona të supozuar për pjesëmarrje dhe bashkëpunim në konfliktet e huaja. Strategjia parasheh fazën e identifikimit të ekstremizmit të dhunshëm, parandalimit, deradikalizmit dhe integritit të tyre në shoqëri. Rëndësi të veçantë brenda strategjisë parashihet bashkëpunimi gjithëpërfshirës nga autoritet e zbatimit të ligjit, shoqërisë civile, mediat dhe roli i komunitetit fetar në drejtim të luftimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë.

8 Ligji për ndalimin e bashkimit në konflikte jashtë territorit të Kosovës: [https://ëëë.mpb-ks.org/repository/docs/LIGJI\\_NR\\_05\\_L\\_002\\_PER\\_NDALIMIN\\_E\\_BASHKIMIT\\_NE\\_KONFLIKTE\\_TE\\_ARMATOSURA\\_JASHTE\\_TERRITORIT\\_TE\\_VENDIT.pdf](https://ëëë.mpb-ks.org/repository/docs/LIGJI_NR_05_L_002_PER_NDALIMIN_E_BASHKIMIT_NE_KONFLIKTE_TE_ARMATOSURA_JASHTE_TERRITORIT_TE_VENDIT.pdf)


9 Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2013-2020: [http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA\\_parandalim\\_-\\_SHQIP.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_parandalim_-_SHQIP.pdf)



Qytetarët nuk kanë vlerësuar pozitivisht përpjekjet e deritanishme të Qeverisë së Kosovës në drejtim të luftimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Rreth 57 përqind e qytetarëve të anketuar deklaruan se Qeveria e Kosovës nuk ka pasur sukses në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë, ndërsa në anën tjetër, rreth 35 përqind e të anketuarve deklaruan deri diku të suksesshme punën e Qeverisë në drejtim të luftimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Megjithatë, përcëptimi publik për këtë çështje nuk dallon nga përcëptimi për çështjet tjera që vazhdon të jetë negativ.

Për sa i përket suksesit të Qeverisë rreth këtij fenomeni global ku është e prekur edhe Kosova, qytetarët vlerësuan vetëm 5 përqind të suksesshme punën e Qeverisë në parandalimin e ekstremizmit në Kosovë dhe metodave të aplikuara deri më sot duke përfshirë strategjinë e miratuar nga Qeveria së Kosovës, dhe rehabilitimi i tyre pasi të jenë kthyer nga Siria dhe Iraku. Ndërsa vetëm 3 përqind e tyre nuk kanë fare mendim për përpjekjet e Qeverisë në luftimin e ekstremizmit dhe radikalizmit në Kosovë. Këto përqindje të ulëta u vlerësuan për faktin që Qeveria e Kosovës ende nuk ka filluar ta zbatoj ndonjë plan të strategjisë së miratuar rreth qytetarëve të cilët ishin pjesë e konfliktit në Siri dhe Irak.

**Figura 17: Përcëptimet e qytetarëve rreth punës së Qeverisë së Kosovës rreth luftimit të ekstremizmit**



---

## PUBLIKIMET E MËPARSHME NË KUADËR TË BAROMETRIT KOSOVAR TË SIGURISË

---

Trendet e perceptimeve të qytetarëve për sigurinë publike në Kosovë- **Maj 2016**

Perceptimet e qytetarëve për integritetin në Policinë e Kosovës- Shkurt 2016

Perceptimet e Publikut për Politikën e Jashtme dhe Dialogun me Serbinë, Shkurt 2016

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i pestë, Dhjetor 2015

Trendët e besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë për periudhën 2012-2015, Shtator 2015

Perceptimet e Qytetarëve për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Janar 2015

Perceptimet e Publikut për Politikën e Jashtme dhe Dialogun me Serbinë, Janar 2015

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i katërt, Dhjetor 2014

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i tretë, Dhjetor 2013

Barometri Rajonal i Sigurisë, Dhjetor 2013

Barometri Kosovar i Sigurisë - Zërat e Kosovës: Vështrimet dhe Perceptimet, Maj 2013

Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i parë, Dhjetor 2012

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)

Barometri Kosovar i Sigurisë : Pikëpamjet e qytetarëve ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Kosovë / Interpretues i të dhënave Vesë Kelmendi.  
- edicion special Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2016. – 28 f. :  
ilustr. me ngjyra ; 21 cm.

**ISBN 978-9951-679-42-8**

ISBN 978-9951-679-42-8



9 789951 679428

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)